

KONTRATE BINJAKEZIMI

Perkrahje per Statistikat

Kosove



RAPORT MBI MISIONIN

**Activiteti 1.3.1: Prezantim i raporteve te cilesise
sipas standardeve te
Eurostat-it**

Aktiviteti 1.3.1 eshte pjese e komponentit numer 1: Nje sistem Cilesie per Statistikat

Misioni i realizuar nga Mogens Grosen Nielsen

7-9 Prill 2014

Emri, adresa, emaili i autorit

Mogens Grosen Nielsen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel. +45 3917.3894
mgn@dst.dk

Permbajtja

1. KOMENTE TE PERGJITHSHME	5
2. METODOLOGJIA E ANALIZES GJATE MISIONIT	5
3. SITUATA SOT	8
3.1 FAKTORET AMBIENTALE – STANDARDET, METADATA, ETJ.....	8
3.2 REKOMANDIMET NGA AKTIVITETI 1.0.1	8
3.3 CESHTJET E IDENTIFIKUARA GJATE TAKIMIT	9
4. REKOMANDIMET	9
4.1 NIVELI STRATEGJIK / ORGANIZATES.....	9
4.2 NIVELI I PROJEKTIT/PROCESEVE	10
4.3 NIVELI TEKNIK/IMPLEMENTIMIT	10
4.3 ORGANIZIMI.....	11
5.4 HARTA RRUGORE	11
ANEKSI 1. TERMAT E REFERENCES	13
ANEKSI 2. REKOMANDIMET NGA AKTIVITETI 1.0.1.....	FEJL! BOGMÆRKE ER IKKE DEFINERET.

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave te Kosoves
ISK	Institut Statistikor Kombetar
ICBS	Byroja Qendrore e Statistikave e Izraelit
CoP	Kodi i Praktikes i Statistikave Evropiane
QAF	Korniza e Sigurimit te Cilesise
HLG	Grupi i Larte per Modernizimin e Produkteve dhe Sherbimeve Statistikore
GSBPM	Modeli i Pergjithshem i Procesit te Prodhimit Statistikor
GSIM	Modeli i Pergjithshem i Informacioneve Statistikore
CSPA	Arkitektura e Perbashket e Prodhimit Statistikor
QAF	Korniza e Sigurimit te Cilesise e Statistikave Evropiane
DDI	Iniciativa e dokumentimit te te dhenave
SDMX	Shkembimi i te dhenave statistikore dhe metadates
SIMS	Struktura per metadata
ESMS	Struktura evropiane SDMX per metadata
ESQRS	Struktura ESS e raporteve te cilesise
Colectica	Mjeti standard per menaxhimin e metadates per DDI standard
TeR	Termet e References

1. Komente te pergjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuader të Projektit të Binjakëzimit të BE-së midis ASK-së dhe Statistikave të Danimarkës. Misioni është planifikuar si nënkomponent i komponentit 1: Një sistem cilësie për statistikën.

Objektivat konkretë/rezultatet e pritura nga ky mision janë:

- Paraqitja e gjendjes aktuale në lidhje me raportet e cilësise/pershkrimin e produkteve statistikore
- Harta rrugore gjatë projektit për përmbushjen e kërkesave të BE-së në lidhje me pershkrimin e statistikave
- Zgjidhjet e mundshme në fushën e TI-së, që nuk kërkojnë kompleksitet të lartë dhe nuk përfshijnë rrezik të lartë
- Diskutim/koordinim me projektin e SIDA
- Përcjellja e rekomandimeve nga aktiviteti 1.0.1 (Thygesen dhe Vihavainen)

Rekomandohet një qasje e thjeshtë, duke përdorur Excel-in, për futjen e deklaratave të cilësise sipas metodologjisë SIMS. Sipas kërkesës së ASK-së, projekti mund të orientojë resurse/misione për mbështetje teknike.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e konsulentëve dhe e kanë bërë qëndrimin në Kosovë të këndshëm dhe të paharrueshëm.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Metodologjia e analizës gjatë misionit

Qasja e analizës e përdorur gjatë misionit është sipas Menaxhimit të Projektit të Biznesit me fokus në 'gjendjen aktuale' dhe 'gjendjen e ardhshme'.




Figura 1. Metodologjia: Menaxhimi i Procesit të Biznesit

Perspektiva e procesit te biznesit nenkupton vendosjen e fokusit ne proceset, sipas teorise se zinxhirit te vlerave. Cdo nen proces duhet t'i kontribuoje zinxhirit te produktit te ofruar perdoruesit/konsumatorit. Proceset e prodhimit, duke perfshire proceset mbi metadat, duhet te dizajnohen ne ate menyre qe permbushin qellimet e organizates – duke perfshire qellimet e permbushjes se aspektit te kost-efektivitetit.




Figura 2. Perspektiva e procesit te biznesit me elementet ambientale.

Figura 3 pershkruan tri elementet e analizes te ndermarra gjate misionit




Figura 3. Elementet kryesore te analizes. Vini re qe teksti ne ngjyre hiri eshte shtuar bazuar ne rekomandimet nga aktiviteti 1.O.1 lidhur me vendimet strategjike per punen rreth cilesise.

Gjetjet (ceshtjet) e meposhtme jane paraqitur ne tri nivele. Shih figuren me poshte.




Figura 4. Ceshtjet ne tre nivele

Aktiviteti eshte realizuar ne forme takimi pune me pjesemarres nga ASK-ja, te cekur ne termat e references, duke u bazuar ne elementet e siperpermendur metodologjike.

3. Situata sot

3.1 Faktoret ambientale – standardet, metadata etj.

Korniza e pergjithshme per cilesi eshte Kodi i Praktikes i Statistikave Evropiane dhe Korniza e Sigurimit te Cilesise.

Gjate misionit, ekspertet kane bere keto prezantime lidhur me zhvillimet nderkombetare dhe zhvillimet ne Danimarke dhe Suedi.

- Rekomandimet kryesore ne nivel strategjik nga aktiviteti 1.0.1.
- Prezantimi i Kodit te Praktikes dhe Kornizes se Sigurimit te Cilesise, me fokus ne indikatorët e Kornizes lidhur me krijimin e Deklaratave te Cilesise dhe metadatat ne pergjithesi.
- Prezantimi i SIMS, ESMS dhe ESQRS
- Prezantimi i DDI dhe Colectica
- Prezantimi i punes ne metadata ne Statistikat e Danimarkes me fokus te vecante ne implementimin e Deklaratave te Cilesise sipas standardeve te BE-se
- Ceshtjet, rekomandimet, perfshire propozimet per organizimin dhe harten rrugore per punen ne deklaratat e cilesise gjate projektit te binjakezimit.

Perfaqesuesit nga Statistikat e Suedise prezantuan punen rreth metadatave ne vendin e tyre dhe punen nderkombetare qe bejne ne metadata, duke perfshire aktivitetet ne GSIM, GSBPM, HLG dhe CSPA etj.

3.2 Rekomandimet nga aktiviteti 1.0.1

Rekomandimet nga aktiviteti 1.0.1 jane paraqitur ne kater grupe:

1. Krijimi i Komitetit per Cilesi (ose Grupit per Menaxhimin e Cilesise) dhe emerimi i menaxherit te cilesise (ne prill te vitit 2014, Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-se ka emeruar Zyrtaren e Larte te Metodologjise. Znj. Servete Muriqi, si menaxhere te cilesise. Ne te njejten kohe eshte formuar edhe Komiteti per Cilesi, i perbere nga anetare te menaxhmentit te larte te ASK-se, nga te gjitha departamentet)
2. Ndertimi i kapaciteteve
3. Metadatat
4. Perdoruesit

Lidhur me metadatat, eshte rekomanduar si ne vijim:

- a) Raportet sipas ESMS ne webfaqe jane nje fillim i mire por duhet te azhurnohen
- b) Duhet te perfshihen te gjitha fushat
- c) Duhet te vendoset nje sistem teknik
- d) Duhet te kete koordinim me projektin e SIDA per te evituar dyfishimet e aktiviteve

Te gjitha rekomandimet e tjera nga aktiviteti 1.0.1 jane te rendesishme, sidomos aspekti organizativ. Perdorimi/implementimi i GSBPM (modeli i pergjithshem i procesit te prodhimit statistikor) duhet

gjithashtu te nenvizohet pasi ky model ka rolin kyc ne implementimin konkret te deklaratave te cilesise.

Ne aneksin 2 paraqiten ne menyre te plote te gjitha rekomandimet nga aktiviteti 1.0.1.

3.3 Ceshjtjet e identifikuara gjate misionit

Gjate misionit jane identifikuar keto ceshjtje.

Ne nivel strategjik, u diskutuan keto ceshjtje:

1. Ekziston nevoja per nje plan realist lidhur me punen ne deklaratat e cilesise. Pervец kesaj, eshte e rendesishme te kete nje perkushtim te fuqishem dhe vendimet e nevojshme nga menaxhmenti i larte per mbeshtetjen e kesaj fushe
2. Ekziston nevoja per me shume informata ne pergjithesi se cilat jane kerkesat nga Eurostat-i, si mund te sigurohet transparenca permes punes ne deklaratat e cilesise etj.
3. Keto aktivitete duhet te definohen/prezantohen me mire ne menyre qe te gjithe te involvuarit ta kene te qarte terminologjine, qe lidhet me cilesine/metadatat
4. Aktualisht ASK-ja raporton informacione te cilesise tek FMN-ja dhe organizatat e tjera. Do te ishte e dobishme nese informacionet e njejta futen nje here dhe pastaj riperdoren per qellime te ndryshme, duke perfshire raportimin tek organizata te ndryshme nderkombetare.

Ne nivel procesesh/projektesh, u diskutuan keto ceshjtje:

1. Eshte e veshtire te behen ndryshme ne organizate dhe eshte e veshtire te ndryshohen procedurat ekzistuese te punes me statistikat.
2. Nuk ka staf te mjaftueshem me njohurite e nevojshme per implementimin e deklaratave te cilesise.

Ne nivel teknik/implementimi, u diskutuan keto ceshjtje:

1. Nuk ka resurse dhe njohuri te mjaftueshme per metadatat dhe aplikimin e instrumenteve /programeve te reja, dhe eshte e veshtire te gjenden resurset per aplikimin/pershtatjen e tyre. U diskutuan mundesite e fillimit me programe te thjeshta.
2. U diskutua edhe qasja me e pergjithshme afatgjate ndaj sistemit te metadatas mbi bazen e prezantimeve te Mogens Grosen dhe Klas Blomqvist nga Statistikat e Suedise.

4. Rekomandimet

4.1 Niveli strategjik / i organizates

U dhane dhe dakorduan keto rekomandime:

Objektivat strategjike per punen ne deklaratat e cilesise jane:

- 1) Prodhimi kost-efektiv duke perdorur GSBPM, SIMS dhe standardet e tjera
- 2) Permiresimi i i cilesise se procesit duke perdorur GSBPM dhe cilesise se produkteve duke perdorur SIMS dhe standardet e tjera
- 3) Permbushja e nevojave te perdoruesve (duke perfshire kerkesat e BE-se)

Aktivitetet, qe lidhen me deklaratat e cilesise, gjate kohezgjatjes se projektit duhet te perfshijne

- 1) Udhezuesit dhe trajnimet
- 2) Sisteme te thjeshta teknike
- 3) Deklaratat e Cilesise sipas standardeve te BE-se per te gjitha statistikatat (permbajtja)

Eshte rekomanduar te formohet Grupi per Cilesi/Komiteti per Cilesi. Ky, dhe rekomandimet e tjera, mund te gjendnen ne raportin mbi misionin 1.0.1. Shih aneksin 1. Rekomandimet nga aktiviteti 1.0.1 jane te detajizuara me poshte, duke perfshire Grupin per Cilesi, mjetet, udhezuesit etj.

4.2 Niveli i projekteve/proceseve

Eshte rekomanduar te formohet nje Grup per Menaxhimin e Cilesise, i udhehequr nga koordinatori i cilesise. Detyrat per kete grup jane paraqitur ne seksionin per organizimin. Ne aspektin e implementimit te cilesise, ky grup duhet te siguroje trajnime dhe mbeshtetje per stafin ne fushat specifike per implementimin e deklaratave te cilesise. Organizata dhe proceset e punes ne nivel fushash duhet te ndjekin planin dhe udhezimet e pergatitura nga Grupi per Menaxhimin e Cilesise.

4.3 Niveli teknik/i implementimit

1. Rekomandohet te fillohet me nje sistem te thjeshte (Excel ose te ngjashem). SIMS (Struktura e vetme e integruar per metadata) duhet te perdoret si strukture per konceptin e cilesise. Kjo mund te behet duke futur kete strukture ne Excel.
2. ESMS ekzistuese duhet te shnderrohet ne formatin SIMS.
3. Lidhur me raportimin ne te ardhmen tek Eurostat-i, rekomandohet te krijohen dosje ne XML ne perputhje me strukturen ESMS ose ESQRS. Dosjet ESMS dhe ESQRS mund te gjenerohen nga SIMS. Pastaj ato mund te ngarkohen ne National Reference Metadata Editor, te ofruar nga Eurostat-i. Ose mund te krijohet modeli sistem-ne-sistem. Ky rekomandim mund te diskutohet dhe ndoshta te implementohet ne fund te projektit te binjakezimit.
4. Ne aspektin afatgjate, metadatat ne sistemin e thjeshte duhet te integrohen ne nje sistem me te integruar per metadata. Statistikat e Danimarkes perdorin mjetin Colectica per te siguruar integrimin. Duke perdorur nje mjet si Colectica ekziston mundesia e importimit te informacioneve nga Excel-i, prandaj – nje periudhen afatgjate – siguron kalimin nga nje sistem i thjeshte ne nje sistem me te integruar me llojet e tjera te matadatave, si klasifikimet, grupet e te dhenave, variablat etj. Rekomandohet te behet nje vleresim i Colectica dhe mjeteve te tjera, qe plotesojne nevojat e ASK-se, duke perfshire punen ne deklaratat e cilesise.
5. Projekti i Binjakezimit bashke me projektin e SIDA do te diskutojne dhe alokojne mbeshtetje teknike per implementimin e SIMS ne Excel ose dicka te ngjashme.

Perverc ketij raporti, jane siguruar edhe materialet e meposhtme per fillimin e punes:

1. Prezantimet nga misioni
2. Manuali teknik per Struktura e vetme te integruar per metadata (SIMS)
3. Tre shembuj per organizimin dhe diseminimin e deklarates se cilesise.
 1. Konceptet SIMS sipas struktures SIMS-id.
 2. Konceptet SIMS te organizuara sipas fazave ne modelin GSBPM.
 3. Konceptet SIMS te organizuara me qellim te sigurimit te qasjes se lehte te perdoruesve tek informacionet.

Rekomandohet të përdoret struktura nga shembulli 1 ose shembulli 2 në dosjet që përmbajnë deklaratat e cilesise. Kjo përzgjedhje e strukture duhet të vendoset në kuadër të grupit për cilesi.

4.3 Organizimi

Rekomandohet të ndërmerren këto aktivitete organizimi:

Komiteti/Grupi për Cilesi. Udhehequr nga Kryesuesi i Grupit

Detyrat: diskutimi dhe aprovimi i planeve, raporteve mbi përcjelljen e punës etj.

Grupi për Cilesi. Kryesuesi i grupit.

Detyrat:

1. Zhvillimi dhe aprovimi i planit për implementimin e deklaratave të cilesise bashkë me menaxhmentin e lartë dhe përgatitja e raporteve mbi përcjelljen e punës dhe informacione të tjera ekzekutive. Shih hartën rrugore mëposhte.
2. Përgatitja e modeleve, udhëzuesve dhe sistemeve për punën në deklaratat e cilesise. Kjo përfshin përgatitjen e SIMS në një program të thjeshtë (p.sh. Excel) dhe udhëzime të thjeshtë për futjen e informacioneve duke përdorur GSBPM si model të përgjithshëm. Manuali teknik mbi SIMS i BE-së përmban udhëzime për secilin koncept të cilesise në SIMS.
3. Sigurimi i Cilesise i Deklaratave të Cilesise bashkë me personat përgjegjës për fushat specifike. Në këtë aspekt duhet të ketë një listë të thjeshtë të gjerave, që duhet të kontrollohen (check-list).
4. Ndërtimi i kapaciteteve /komunikimit (shpërndarja e njohurive për GSBPM, SIMS etj)

Departamentet (personat e fushave perkatese pergjegjes per anketat)

Detyrat: Paraqitni në një model sipas planit dhe përgatitni për rishikim. Merrni pjesë në rishikim dhe përfshini rekomandimet nga rishikimi.

5.4 Harta rrugore

Aktiviteti	Afatet kohore
Takim mbi prezantimin e komitetit të cilesise	Qershor 2014
Prgatitja e planit, modeleve, udhëzuesve (menaxheri i cilesise) – me ndihmën nga konsulencat	Shtator 2014
Prodhimi i dokumentacionit sipas modelit (3 anketa pilot). Të përfshira vetëm konceptet e ESMS	Tetor 2014
Vlerësimi dhe azhurnimi i planit, i pasuar nga një takim i komitetit të cilesise	Tetor 2014

Finalizimi i dokumentacionit mbi te gjitha anketat (1 vit)	Nentor 2015
Vleresimi dhe vendosja per aktivitetet ne te ardhmen (duke perfshire	Dhjetor 2015
Pergatitja per ndertimin e nje sistemi te integruar te metadatave	Pas 2015

Tabela 1. Plani per punen mbi implementimin e deklarave te cilesise

Aneksi 1. Termat e References



Projekti i Binjakezimit i BE-se KS12 IB ST 01 Perkrahje per Statistikat

Termat e References:

Komponenti 1: Nje sistem cilesie per statistikat

Aktiviteti 1.3.1:Prezantimi i raporteve te cilesise sipas standardeve te BE-se

Afatet kohore:

TeR –te gatshem: 21 Mars 2014

Fillimi /perfundimi i aktivitetit: 7-11 Prill 2014

Raportimi: 16 Prill 2014

Rezultatet obligative te komponentit:

	Aktiviteti	Pike referimi	Burim informacioni	Supozimet (jashte projektit)
--	------------	---------------	--------------------	------------------------------

Rezultati obligativ 1.3	Prezantimi i raporteve te cilesise sipas standardeve te Eurostat-it	• Raporti I misionit, qe pershkruan punen e bere, harten rrugore, afatet kohore per implementimin, te publikuara ne faqen e projektit • Pergatitja e deklarates se cilesise. • Diskutimi i rekomandimeve per softverin relevant • Identifikimi i anketave per testimin (pilot) e implementimit te deklarave te cilesise	• Raportet tremujore te projektit • Raportet mbi misionet • Dokumente te ndryshme per ASK-ne	• Përkushtimi dhe disponeshmeria në të gjitha nivelet e stafit të ASK-së dhe menaxhmentit • Komunikimi dhe pjesëmarrja efektive e të gjitha subjekteve relevante • Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, midis misionëve • Resurse të mjaftueshme (njerëzore dhe materiale)
--------------------------------	---	--	--	--

Tema / qellimi i aktivitetit 1.3.1

Ky mision do te ofroje nje prezantim/hyrje ne standardet evropiane per pershkrimin e statistikave. Ky eshte nje mision, qe realizohet edhe me ekspertet nga SIDA. Ata do te paraqesin mendimet e tyre ne lidhje me punen rreth pershkrimit te statistikave, dhe do te ofrojne shembuj te softvereve, qe perdoren per deklaratat e cilesise. Ekipi i ASK-se do te paraqese idete e tyre ne lidhje me punen rreth cilesise ne kete institucion.

Ne fund te aktivitetit 1.3.1:

Do te pergatitet nje raport mbi misionin, ku pershkruhet gjendja aktuale e pershkrimit te statistikave ne ASK, si dhe nje harte rrugore per aktivitetet ne kuader te projektit ne lidhje me permbushjen ne ASK te kerkesave te BE-se per pershkrimin e statistikave. Aktivitetet e tjera duhet te marrin parasysh rekomandimet nga misioni 1.0.1 (Thygesen dhe Vihavainen)

Pershkrimi i softvereve te mundshem te TI-se, qe mund te perdoren per publikimin ne internet te pershkrimit te statistikave sipas rekomandimeve/kerkesave te Eurostatit, duke perfshire vleresimet e kostos dhe vleresimet per kohen e nevojshme per implementimin teknik te tyre.

Duke pasur parasysh resurset e kufizuara te TI-se ne ASK, duhet te merren ne konsiderate sisteme te thjeshta teknike dhe me rreziqe te ulta. Mbeshtetja e TI-se ne publikimin e pershkrimit te statistikave duhet te jete prioritet ne projektin e binjakezimit.

Lista e aktiviteteteve ne kuader te 1.3 – ne projektin e binjakezimit- te koordinuara me SIDA ne fushat e njejta, softver dhe metodologji.

Stafi i ASK-se:

Z. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, ramiz.ulaj@rks-gov.net ASK (Udhëheqës i komponentit)
Ibrahim Rrustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; ibrahim.rrustemi@rks-gov.net
Hazbije Qeriqi, Përgjegjëse për Komunikim dhe Informim; hazbije.qeriqi@rks-gov.net
Arta Salihu, Zyrtare e Larte per Koordinim; arta.salihu.morina@rks-gov.net
Burim Limolli Shef i TI-se; burim.limolli@rks-gov.net
Bekim Canolli, Shef i Divizionit të Metodologjisë; bekim.canolli@rks-gov.net
Drita Sylejmani, Zyrtare e Larte per Diseminim, drita.sylejmani@rks-gov.net

Ekipi i projektit ne ASK:

Udhëheqës i Projektit, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombetare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net
Homologe e keshilltarit rezident te binjakezimit, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Larte per Marredhenie me Jashte, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertet e vendeve anetare:

Z. Mogens Grosen, Keshilltar i Larte, Sigurimi i Cilesise dhe META data, Statistikat e Danimarkes, MGN@dst.dk
Z. Flemming Dannevang, Keshilltar i Larte, Sigurimi i Cilesise dhe META data, Statistikat e Danimarkes, FDA@dst.dk

Stafi i SCB:

Klas Blomqvist, Ekspert ne Meta data ne SCB, klas.blomqvist@scb.se
Catrin Karling, Keshilltare e Larte, catrin.karling@scb.se
Kjell Tambour, Keshilltar i Larte, kjell.tambour@scb.se

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, keshilltar rezident i binjakezimit (RTA), pkn@dst.dk
Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Historiku

ASK-ja pershkruan disa procedura per monitorimin e cilesise lidhur me stade te ndryshme te procesit te prodhimit statistikor, nga planifikimi dhe dizajnimi i anketave, mbledhja dhe perpunimi i te dhenave, deri tek analiza dhe diseminimi i tyre. Kryesisht perdoren rekomandimet e Eurostat-it dhe praktikat me te mira si udhezues. Zhvillimi i cilesise dhe trajnimet kryesisht ofrohen nga eksperte nderkombetare.

AGA e fundit (Vleresimi i Adaptuar Global) mbi sistemin statistikor ne Kosove thekson qe ASK-ja duhet te zhvilloje nje politike dhe plan per permiresimin e menaxhimit te cilesise (perfshire masat organizative, procedurat, trajnimet dhe veprimet specifike). Pjese e rendesishme e kesaj do te jete permiresimi i dokumentimit/metadatave (duke perfshire ceshtjet mbi metodologjine dhe cilesine per permiresimin e transparences).

Ne raportin e misionit ne komponentin e Cilesise ne kuader te projektit, te ndermarre nga Z. Lars Thygesen dhe Znj. Hilka Vihavainen thuhet:

ASK-ja ka filluar te publikojë përshkrimet e metadatave bazuar ne formatin e ESMS. <http://esk.rks-gov.net/ENG/metadata>. Deri tani janë publikuar vetëm disa përshkrime. Megjithatë, nuk ka një sistem azhurnimi të përshkrimeve aktuale. Është thënë që sistemi është jo efektiv pasi nuk bazohet

në ndonjë databazë. Për këtë arsye është e nevojshme të vendoset një sistem, që është teknikisht më i avansuar, mund të shfrytëzohet për qëllime të ndryshme dhe në planin afatgjatë mund t'i kontribuojë sistemit të integruar për metadata. Projekti i SIDA-s i Suedisë përfshin poashtu një komponent, që ka për qëllim zhvillimin e një sistemi për metadata në ASK.

Bazuar në këto argumente, është konstatuar se:

- *Raportet e Cilesise sipas ESMS ne web faqe janë një fillim i mirë*
- *Por azhurnimi duhet të bëhet gjithsesi*
- *Duhet të mbulohen të gjitha fushat*
- *Duhet të vendoset nje sistem teknik*
- *Duhet të sigurohet koordinimi me projektin SIDA në mënyrë që të shmanget përfshirja e aktiviteteteve të njëjta.*
- *Se shpejti një mision (misioni nr 1.3.1) që do te percaktoje drejtimin e aktiviteteteve.*

Aktivitetet ne kuader te komponentit 1 te Projektit te Binjakezimit do te perfshijne nje numer aktivitetesh, te dizajnuara per fillimin e monitorimit sistematik te cilesise ne Kosove.

Dokumentet, qe duhet te sigurohen si pergatitje per misionin:

ASK-ja duhet te siguroje informacionet relevante per ekspertet e vendeve anetare:

Lista e dokumenteve mund te bashkengjitet ne termat e references, te perfshihet si aneks ose te njejtave ekspertet mund t'u referohen ne web-faqen

- Raporti i Vleresimit te Adaptuar Global (AGA)
- Programi i statistikave zyrtare 2013 -2017
- Plani i Zhvillimit Strategjik 2009- 2013
- SIDA: Projekti i Bashkepunimit 2014-2017
- Dekker-Raporti final
- Raporti mbi misionin 1.0.1 (Thygesen dhe Vihavainen)

Aktivitetet e pritura jane:

- Prezantim i terminologjise mbi metadat
- Prezantim i sistemeve teknike per te dhenat dhe informacioneve te cilesise te kerkuara nga Eurostat /kerkesat nderkombetare
- Harta rrugore per implementimin e nje sistemi te ri per menaxhimin e informacioneve te cilesise
- Krijimi i nje plani te detajuar per aktivitetet ne kuader te Projektit te Binjakezimit
-

Pas misionit, do te pergatiten:

- Raporti mbi misionin – sipas modelit per raportim
- Plani i detajuar per aktivitetet e ardhshme ne nenkomponentin 1.3 ne kuader te projektit
- Marreveshja midis ASK-se dhe SIDA-s per punen e metejme ne dokumentimin dhe metadat ne kuader te projektit te binjakezimit dhe projektit te SIDA

Aneksi 1. Programi, - Prill 2014

Dita	Vendi	Koha	Aktiviteti
1	ASK	09:00	Planifikimi i javes
		09:30	ASK: Veshtrim mbi punen rreth cilesise ne ASK dhe idete e ASK-se ne lidhje me standardet e cilesise
		10:30	Pushim per kafe
		11:00	Ekspertet: Kodi I Praktikes I Statistikave Evropiane per Cilesi
		12:00	Dreka
		13:15	Eksptet: Standardet e cilesise ne Statistikat e Danimarkes dhe Suedise, Z. Mogens Grosen, Z. Flemming Dannevang dhe Z. Klas Blomqvist
		14:30	Pushim per kafe
		15:00	Vazhdim
		16:30	Konkluzionet preliminare
2	ASK	09:00-16:00	Takim pune: Metodologjia dhe softveri per deklaratat e cilesise. Shembuj, demonstrime, diskutime, pervojat e SBC ne Shqiperi
3	ASK	09:00-16:00	Vazhdim
4	ASK	09:00	Takime
		10:30	Pushim per kafe
		10:45	Takim pune: Rekomandimet dhe afatet kohore
		12:00	Dreka
		15:00	Takim permbledhes me udheheqesin dhe pjesemarresit : rekomandimet, afatet kohore dhe programi i aktiviteteve qe do te ndermarre ASK-ja
5	ASK	09:00	Shkrimi i raportit
		10:30	Pushim per kafe
		10:00	Shkrimi i raportit
		12:00	Dreka
		13:15	Takim perfundimtar: ekspertet, udheheqesi i projektit, RTA

Aneksi 2

3.1. Rekomandim: Organizimi për Cilësi

Krijimi i Komitetit për Cilësi (ose Grupi Drejtues për Cilësi)

Do të duhej të formohej një Komitet i nivelit të lartë për Cilësi dhe të fillojë punën para fundit të prillit të vitit 2014. Puna e këtij grupi pastaj duhet të diskutohet gjatë aktivitetit 1.2, që pritet të mbahet në maj.

Detyrat e grupit duhet të përfshijnë:

- *Përkufizimin e deklaratës së përkushtimit për cilësi si dhe publikimi në web faqe në përputhje me Kodin e Praktikës*
- *Miratimin e modelit GSBPM si bazë për udhëzuesit për cilësi, udhëzuesit për metadata dhe menaxhimin e ASK-se (shih <http://www1.unece.org/stat/platform/display/GSBPM/GSBPM+v5.0>)*
- *Përgatitjen dhe miratimin e udhëzuesve dhe standardeve për cilësi për procese të punëve specifike;*
shembull:
 - *Procedurat për trajtimin e gabimeve në statistikat e publikuara*
 - *Udhëzuesin për mostra dhe vlerësime*
- *Të sigurojë që përkushtimi për cilësi dhe udhëzuesit për cilësi të kuptohen dhe të ndiqen nga të gjithë në organizatë.*

Kryesuesi i grupit duhet të vijë nga menaxhmenti i lartë, sepse detyrat e grupit janë shumë të rëndësishme për të gjitha proceset në ASK. Kjo poashtu duhet të jetë si një sinjal për gjithë organizatën që përkushtimi dhe udhëzuesit për cilësinë kanë prioritet të lartë.

Emërimi i një personi në pozitën e Menaxherit të Cilësisë

Është e rëndësishme të ketë një Menaxher për Cilësi, që është i përkushtuar për detyrat në vijim:

- *Mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe udhëzuesve për cilësi në tërë organizatën.*
- *Hartimi dhe diskutimi i udhëzuesve*
- *Përcjellja e punës ndërkombëtare në cilësinë në statistika dhe në këtë mënyrë informimi rreth praktikave më të mira, që mund të përdoren si inspirim.*
- *Sekretari i grupit drejtues*

Profili: Menaxheri për Cilësi idealisht do të duhej të kishte përvojë në disa fusha të statistikave. Ai ose ajo duhet të ketë dëshmuar në mënyrë të qartë se ka një mënyrë pune të organizuar dhe të menduar sistematik, si dhe ka treguar interesim për punën në cilësi.

3.2 Rekomandim: Ndertimi i kapaciteteve

Sipas ASK-së, sigurimi i cilësisë për të dhënat statistikore është përgjegjësi e krerëve të produkteve statistikore. Ata zakonisht e vlerësojnë cilësinë kur produkti (p.sh. publikimi) është gati.

Megjithatë, është shumë e rëndësishme që i gjithë stafi të kuptojë rëndësinë e cilësisë së produktit statistikor në të gjitha fazat e tij. Gjithashtu, është bërë e qartë se punonjësit e rinj të ASK-së në vecanti duhet të ndjekin trajnim specifik për statistikat pasi ky lloj trajnime nuk ofrohet në asnjë shkollë/universitet në Kosovë. Stafi i ASK-së ka nevojë për më shumë trajnime, në lidhje me çështjet e cilësisë, si dhe në përgjithësi për metodat dhe mjetet statistikore.

Bazuar në këto argumente, rekomandohet që:

- *Dy anëtarë të stafit të ASK-së të marrin pjesë në Konferencën e Cilesise- Q 2014 në Vienë prej 2-5 Qershor <http://www.q2014.at>. Është propozuar që ky aktiviteti të financohet nga projekti dhe Keshilli Drejtues i Projekti do të marrë këtë vendim në mbledhjen e parë. Q2014 është një ngjarje e rëndësishme evropiane, ku mund të shihet se çfarë po bëhet në lidhje me cilësinë në agjenci të ndryshme statistikore. Së paku njëri prej pjesëmarrësve duhet të jetë personi, që do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe koordinimin e punës rreth cilësisë në ASK.*
- *Gjatë misionit të ardhshëm, në Maj të 2014, si pjesë e misionit të tyre, dy konsulentët do të mbajnë një ditë trajnim për cilësi për anëtarët e stafit të fushave të ndryshme statistikore. Trajnimi mund të përfshijë p.sh. temat në vijim:*
 - *Cilësia në Statistika*
 - *Dimensionet e cilësisë në Sistemin Statistikor Evropian*
 - *Procesi i Cilësisë*

ASK-ja do të përpilojë draftin e programit të trajnimit për stafin. Programi i trajnimit do të përpilohet në bazë të nevojave që identifikohen në organizatë. Rekomandohet që para misionit të ardhshëm të bëhet një hulumtim për mangësitë e mundshme dhe nevojat për trajnime. Mund të bëhet në mënyrë sistematike nga ana e menaxherëve të njësive. Para misionit të ardhshëm konsulentët do të shikojn për mundësit që ofrohen nga kurset e-mësimeve. ASK do të shikojë se a do të mbahen gjatë vitëve të ardhshëm kurse Evropiane (të financuara p.sh. nga programi IPA). Qëllimi pastaj është të finalizohet programi i trajnimit gjatë verës 2014.

3.3.Rekomandim: Metadata

ASK-ja ka filluar të publikojë përshkrimet për metadata bazuar në formatin e ESMS. <http://esk.rks.gov.net/ENG/metadata>. Deri tani janë publikuar vetëm disa përshkrime. Megjithatë, nuk ka një sistem azhurnimi të përshkrimeve aktuale. Është thënë që sistemi është jo efektiv pasi nuk bazohet në ndonjë databazë. Për këtë arsye është e nevojshme të vendoset një sistem, që është teknikisht më i avancuar, mund të shfrytëzohet për qëllime të ndryshme dhe në planin afatgjatë mund t'i kontribuojë sistemit të integruar për metadata. Projekti i SIDA-s i Suedisë përfshin poashtu një komponent, që ka për qëllim zhvillimin e një sistemi për metadata në ASK.

Bazuar në këto argumente, është konstatuar se:

- *Raportet e Cilesise sipas ESMS ne web faqe janë një fillim i mirë*
- *Por azhurnimi duhet të bëhet gjithsesi*
- *Duhet të mbulohen të gjitha fushat*
- *Duhet të vendoset nje sistem teknik*
- *Duhet të sigurohet koordinimi me projektin SIDA në mënyrë që të shmanget përfshirja e aktiviteteteve të njëjta.*
- *Se shpejti një mision (misioni nr 1.3.1) që do te percaktoje drejtimin e aktiviteteteve.*

3.4. Rekomandim: Përdoruesit

Publikimi në web faqe i statistikave ka rritur padyshim numrin e përdoruesve të statistikave në Kosovë krahasuar me të kaluarën. Një prej detyrave kryesore është nxitja e mëtejme e përdorimit të të dhenave statistikore. Ka mënyra të ndryshme për ta arritur këtë. Është shumë me rëndësi të takohen përdoruesit dhe të pyeten për kërkesat e tyre dhe mangësitë e mundshme në lidhje me produktet statistikore. Pasi të merren mendimet e tyre, është shumë e rëndësishme që ato të analizohen në mënyrë të duhur dhe të nxirren konkluzione për përmirësime të mëtejme.

Për këtë arsye rekomandohet që;

- *Të mbahet një Konferencë me përdoruesit kyç*
 - *Kjo do të duhej të përfshihej në aktivitetin e paraqitjes së fillimit të projektit, që do të mbahet në fillim të marsit apo prillit 2014*
- *ASK-ja mund të përdorë ekspertët e projektit që të ndihmojnë në lidhje me seminarët me përdoruesit në fusha të ndryshme.*
- *Në aspektin afatgjatë duhet të mbahen mbledhje të rregullta me grupe të përdoruesve p.sh. një herë në vit, p.sh. në:*
 - *Statistikat sociale*
 - *Statistikat ekonomike*
- *ASK-ja të fillojë me përdorimin e anketave lidhur me kënaqshmërinë e përdoruesve duke parë shembuj të këtyre anketave, që përdoren në vendet e tjera.*
 - *Anketa në lidhje me besueshmërinë e publikut në përgjithësi sipas standardeve të OECD <http://www.oecd.org/std/50021100.pdf>*
 - *Duhet të ndërmerren edhe anketa të tjera me përdoruesit për të matur se sa janë ata të kënaqur me produkte të caktuara statistikore, me web faqen, me qasjen në një database diseminimi; një shembull mund të jetë. http://www.dst.dk/~media/Kontorer/16-Formidlingscenter/maal-og-resultater/report_on_usersatisfaction_survey_statbank2007-pdf.pdf*
 - *Në misionin e ardhshëm konsulentët do të duhej të rishikojnë punën që është kryer deri në atë kohë dhe do të ofrojnë rekomandime për anketat*
 - *Ekspertët do të dërgojnë më shumë shembuj së shpejti.*